



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Të Nxënët Dhe Menaxhimi I Klasës

Ngarkesa: 7 kredite, 30 seminare, 60 leksione

Viti, semestri kur zhvillohet: Viti I, Sem II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor “ Mësuesi në Gjuhën Angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kursi synon që studentët të dinë të përdorin gjuhën e huaj për të plotësuar nevojat e tyre komunikative në një kontekst të industrisë së biznesit, të bëhen më me besim gjatë komunikimit, të njohin e të përdorin gjuhë specifike për të zgjidhur nevojat komunikative, të dinë të përdorin terminologjinë specifike në të katër aftësitë gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, leximin dhe të shkruarit) si dhe të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre ndërkulturore. Zhvillimi i kursit është ndërtuar në mënyrë të tillë që krahas përvetsimit, përsëritjes dhe përforcimit të njohurive gjuhësorë studentët të përfitojnë aftësi kyce për marrëdhënjet me klientët në fushën e biznesit, më promovimin e biznesit nëpërmjet projekteve dhe për përdorimin e internetit për kërkim dhe promovim të turizmit në fushën e biznesit. Përveç përmirësimit të fjalorit në fushën e biznesit, libri gjithashtu ndihmon për të zhvilluar gjuhën e që nevojitet për zhvillimin e aftësive të rëndësishme të komunikimit në fushën e biznesit.

Përdorimi i strategjive të mësimdhënjes që vënë studentin në qendër mundësojnë përvetsimin aktiv të gjuhës për qëllimet e biznesit duke krijuar situata reale pune në fushën e biznesit. Mësimi i strukturave gjuhësorë të nevojshme për përdorim në komunikim në fushën e biznesit lidhet si me situata reale ashtu dhe me përparimin gramatikor.

Në përfundim të lëndës, studenti:

- Identifikon kontributet e rëndësishme historike dhe teorikë në fushën e të nxënit.
- Dallon mes larmishmërisë së teorive të të nxënit
- Diskuton pikat e forta dhe të dobëta të secilës prej tyre.
- Aplikon teori të ndryshme të nxënit për të përmirësuar menaxhimin e klasës, motivimin e nxënësve dhe efikasitetin e të mësuarit.
- Harton orë mësimore të integruara dhe me fëmijën në qendër, që mbështesin zbulimin e nxënësve, autonominë dhe zhvillimin e tyre.
- Organizon klasën dhe mjetet didaktike për organizimin e një ore mësimi bashkëkohore
- Organizon punën e nxënësit në klasë dhe në shtëpi
- Organizon grupet e nxënësve në klasë për të mësuarin bashkëpunimin.